

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/ 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: OPERATORIT EKONOMIK "PAB TIRANA" SHPK

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.6, Rr. E Kavajës, Prona Nr.2/66, ish Kombinati Ushqimor.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur (mall).**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **"Shporta e bebes", me Nr. Reference REF-81546-09-27-2023.**

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i kontratës*): Buletini Nr. 84 datë 09 Tetor 2023

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 93 datë 13 Nëntor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

1. Operatori Ekonomik "PAB TIRANA" SHPK, me NUIS L81829016P

Vlera e ofertës pa tvsh = 23.500.000 (njëzet e tre milion e pesëqind mijë) leke.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "SCREEN AD" shpk & "Luljeta Zanaj" PF me NUIS L11326001A & K36528217C

Vlera e ofertës pa tvsh = 23.460.000 (njëzet e tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) leke.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "SCREEN AD" shpk & "Luljeta Zanaj" PF me NUIS L11326001A & K36528217C**

Për arsyet e mëposhtme:

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se nga BOE “Sreen AD” dhe “Luljeta Zanaj” pf, nuk është klikuar asnjë nga alternativat e përcaktuara sipas pikës 6 gërma (a dhe b) duke mos deklaruar mënyrën se si është bërë ofertimi, sipas përcaktimit në pikën 6/a: në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër apo sipas përcaktimit në pikën 6/b: është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). Në këtë mënyrë pa u proceduar me klikimin si më sipërcituar AK nuk e merr informacionin e nevojshem lidhur me këtë seksion të shtojcës 8.

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojcë e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese.

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se BOE “Sreen AD” dhe “Luljeta Zanaj” pf, nuk ka plotësuar sic duhet formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8, përkatësisht, **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Në formularin e kriterëve të përgjithshme dhe në shtojcat e DST-së objekt prokurimi është kërkuar si më poshtë vijon:

Ofertuesi deklaron se:

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Referuar ekstraktit të regjistrit tregëtar të paraqitur nga operatori ekonomik “Sreen AD“ sh.p.k rezulton se nën cilësinë e administratorit është z. Eptan Lohja, ndërsa nën cilësinë e ortakut rezulton Edmond Topi dhe Eptan Lohja.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “Sreen AD“ sh.p.k pjesë e BOE ka dorëzuar shtojcën 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme nga ku rezulton se ka deklaruar z. Eptan Lohja në cilësinë e administratorit, por jo ortakun e shoqërisë përkatësisht Edmond Topi.

Referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar të paraqitur nga operatori ekonomik “Luljeta Zanaj“ pf rezulton se nën cilësinë e administratorit është znj. Luljeta Zanaj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “Luljeta Zanaj“ pf pjesë e BOE ka dorëzuar shtojcën 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme nga ku rezulton se nuk ka deklaruar zj. Luljeta Zanaj në cilësinë e administratorit.

KVO gjykon se formati standart i shtojcës 8 ”Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, është i tillë që kërkon domosdoshmërisht citimin e cילו anëtari të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, të operatorit ekonomik të cilët nuk duhet të jenë ose të kenë qënë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP.

KVO citon se shtojca 8 “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk lë vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik.

Ju bëjmë me dije se në shtojcën e kriterëve të përgjithshme formati i miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik kërkon që të citohen të gjithë emrat konkretë të të gjithë personave dhe subjekteve që kanë rol vendimarrës pranë shoqërisë përkatëse duke përfshirë dhe ortakun e shoqërisë.

Për këtë shkak shtojca 8 e dorëzuar nga operatori ekonomik “Sreen AD” dhe “Luljeta Zanaj” pf nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor të parashikuar nga neni 75 i LPP-së.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga BOE Sreen AD” shpk dhe “Luljeta Zanaj“ Pf, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën e kriterëve të përgjithshme të miratuar nga APP, për arsytet sa më sipër cituar.

Në rregullat e prokurimit, DST, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1, Hartimi i ofertës, në pikën 1.1 thuhet shprehimisht;

Citoj... 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT.

Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

Përsa cituam më lart shtojca mbi deklaratën e kritereve të përgjithshme do të konsiderohet e paplotë dhe për rrjedhojë e pavlefshme.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

3. AK në rubrikën “Kapaciteti teknik” në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 ka kërkuar shprehimisht si më poshtë vijon:.....

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë.*

BOE kanë paraqitur Autorizim distributori, por që nuk kanë bashkangjitur ...ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. Kanë paraqitur vetem autorizim distributori pa të dhëna të plota të prodhuesit apo dokumenta ku provohet lidhja e tyre me prodhuesin.

Sa me sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80 , nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 79, neni 80, neni 82 **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatori Ekonomik "PAB TIRANA" SHPK, me NUIS L81829016P**, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.6, Rr. E Kavajës, Prona Nr.2/66, ish Kombinati Ushqimor, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **23.500.000 (njëzet e tre milion e pesëqind mijë) leke pa tvsh**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Sheshi “Skënderbej”, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____